



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivered	22	11	3	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKDM&ICK	7056	2023	116	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1303/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1303/2023 të datës 19.10.2023 të ankuesit \_\_\_\_\_ me adresë Rruga \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ kundër Vendimit Nr.45/2023 të datës 19.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I.Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1303/2023 e datës 19.10.2023 e parashtruar nga ankuesi

II.Mbetet në fuqi Vendimi Nr.45/2023 i datës 19.09.2023 i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme më datë 14.07.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr.Reference: RN00012073, për grupin Specialit i Administrimit të Përgjithshëm pozita

*“Inspektor i Tregut”* në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ku afati për aplikim ka qenë nga data 04.08.2023 deri më datë 11.08.2023.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ku më datë 08.09.2023 nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmes Vendimit me Nr. 372/2023, i ka refuzuar aplikacionin për shkak mos plotësimit të kriterëve të konkursit respektivisht mos ofrimi i dëshmisë që nuk ka masë disiplinore. Ankuesi ndaj këtij vendimi ka parashtruar ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmes Vendimit me Nr. 45/2023 të datës 19.09.2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr. 45/2023 të datës 19.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmes, më datë 17.10.2023 përmes postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 19.10.2023 dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.1303/2023 me numër protokoll 6603/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Ndërsa Këshilli me datë 25.10.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 19.10.2023 me numër protokoll 6603/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimit me Nr. 372/2023 të datës 08.09.2023; Konkursin me Nr. Reference: RN00012073, për grupin Specialit i Administrimit të Përgjithshëm pozita Inspektor i Tregut; Vendimin me Nr. 1676/2023 i datës 10.10.2023 për shtyrjen e afatit për përfundimin e procedurave; Vendimin me Nr. 45/2023 të datës 19.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Zarin e datës 17.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 25.10.2023; Lista e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Ankesën e ankuesit; Njoftimin e datës 11.09.2023 dhe 19.09.2023; vendimin me Nr. prot:1320 i datës 25.08.2023 për shtyrjen e afatit për përfundimin e verifikimit paraprak; Aplikacionin e ankuesit i datës 09.08.2023; Diplomën me Nr. 2892, Diplomën me Nr. 1928, Certifikatën e trajnimit prej datës 10-12.05.2023, Certifikatën e datës 30.05.2023, Vërtetimin e lëshuar nga biznesi individual i Vërtetimin e lëshuar nga Vicianumi-H Shpk-Vushtrri; Kontratë punë për punë dhe detyra specifike e datës 11.08.2021, Akt Emërimit e datës 31.03.2023, Dokument identifikimi i ankuesit, Certifikatën e datës 14.06.2019, Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për ankuesin për periudhën 05.05.2021 deri 07.08.2023, Letër motivuese e ankuesit, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 22.05.2023, Kontratë punë për

kohë të caktuar/ pa caktuar e datës 10.09.2018, Vendimin me Nr. 02/164 i datës 09.10.2023 për emërimin e Komisionit të Pranimit për këtë grup.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e pabazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se dokumentet e përvojës së punës në sektorin publik nuk janë marrë parasysh edhe pse i kam dorëzuar, edhe përkundër kësaj më është refuzuar aplikacioni pa bazë juridike.

Kolegji i Këshillit, konstaton se në konkursin Nr. Reference: RN00012073 për grupin Specialistë të Përgjithshëm i Administrimit të Përgjithshëm respektivisht për pozitën " Inspektor i Tregut", kriteret e përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në fusha: Arsim i Lartë i paspecifikuar;*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.*

Në pikën 7 të këtij konkursi si dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin apo aktin që dëshmon se diploma e marrë jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit; Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmie mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale (vërejtje nuk vlen vetëm vërtetimi dhe apo vetëm dokumenti mbështetës është i nevojshme ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve: vërtetimi si dëshmi kryesore dhe nja pasqyrat si dëshmi mbështetëse; Nuk kërkohet dëshmi mbështetëse për përvojën e punës në sektorin publik; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi ka realizuar në cilësinë e trajnuesit; Dëshmi përkatëse se kandidati/ja ka zotësi të plotë për të vepruar (prezantohet nga kandidati nëse ai/ajo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me rezultatin e arritur; Dëshmi mjekësore se kandidati/ja është në gjendje të mirë shëndetësore për kryerjen e detyrës (prezantohet nëse kandidati/ja përzgjidhet për emërim. Dëshmia duhet të jetë jo më e vjetër se gjatë muaj; Certifikatë/vërtetim nga gjykata ose Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjatë muaj nga data e lëshimit; Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar të punës është në sektorin publik, atëherë është i nevojshme vërtetimi nga institucionit ku ka punuar kandidati/ja me të cilën dëshmohet se ai/ajo nuk ka ndonjë masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publikë të pushuar sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë; Nëse përvoja e punës e deklaruar është në sektori privat brenda apo jashtë vendit në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës është ndonjë formë e marrëdhënie kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vetë deklarami i nënshkruar se ai/ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.*

Në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale për pranimin e zyrtarëve publikë të paraparë me nenin 8 të Ligjit që ka qenë në fuqi në këtë periudhë (në vijim Ligji i aplikuar) Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht me paragrafin 1, përcaktohet se: *“Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji”,* ndërsa sipas nenit 12 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurimit, kandidatët duhet të bashkangjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion”.*

Bazuar në provat e lëndës të dorëzuara nga ankuesi me rastin e aplikimit, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi si dokumentacione ka dërguar vërtetimet e përvojës së punës në sektorin privat, mirëpo si dëshmi i njëjti ka dorëzuar edhe Akt Emërimit me Nr. 14940/23 të datës 31.03.2023 me të cilin dëshmohet se është duke mbajtur pozitën Zyrtar për Gjendje Civile 1 në Komunën e Vushtrrisë. Rrjedhimisht lidhur me dispozitat e cekura më lartë, e që kanë të bëjnë me kërkesat për pranim në shërbimin civil po ashtu edhe me kërkesat e parapara me pikën 7 të këtij konkursi, Kolegji i Këshillit, konstaton se nëse kandidatët kanë përvojën e punës në sektorin publik kanë qenë të obliguar të dorëzojnë një dëshmi nga organi i punësimit në sektorin publik me të cilin do të dëshmohet se i njëjti nuk ka ndonjë masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publikë të pushuar sipas ligjit të aplikuar Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. ndërsa kandidatët që përvojën e punës e kanë në sektorin privat atëherë ka qenë obligim që të dërgohet një vetë deklaram të nënshkruar përmes të cilit do të dëshmonte se nuk ka pasur ndonjë masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas ligjit të aplikuar Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë

Si rezultat i kësaj, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar aplikacionin e ankuesit dhe në bazë të shqyrtimit, nuk është gjetur asnjë dëshmi që ankuesi me rastin e aplikimit në pozitën e lartcekur nuk ka ofruar asnjë dëshmi nga organi i punësimit në sektorin publik me të cilin do të dëshmohet se i njëjti nuk ka ndonjë masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publikë të pushuar sipas ligjit të aplikuar Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, po ashtu meqenëse ka punuar në sektorin privat i njëjti nuk ka ofruar asnjë vetë deklaram të nënshkruar përmes të cilit do të dëshmonte se nuk ka pasur ndonjë masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas ligjit të aplikuar Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që kjo ka qenë arsyeja e refuzimit të aplikacionit të ankuesit sipas Vendimit me Nr. 372/2023 të datës 08.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Nisur nga baza ligjore e përmendur si më lartë, dhe nga vlerësimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me Nr. 372/2023 i datës 08.09.2023 i Divizionit për Zhvillimin



e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme është në pajtim me nenin 34 paragrafi 7 të Ligjit të aplikuar Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2, nenin 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe se i njëjti është i arsyetuar në pajtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi Nr.45/2023 i datës 19.09.2023 i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme është në pajtim me gjendjen faktikë dhe bazën juridike.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimi si më lartë, thekson faktin se me vendimin e kundërshtuar me ankesë, ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga e drejta për t'iu nënshtuar procedurave të tjera të pranimit ngase obligimi për të dorëzuar dokumentacionin së bashku me aplikacionin është obligim i kandidatit, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit konstaton se të gjitha pretendimet e ankuesit janë të pabazuara për shkak që nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe faktike, sepse refuzimi i aplikacionit të ankuesit nuk është bërë për shkak të mos plotësimit të kriterëve në aspektin e përvojës së punës, por është refuzimi i aplikacionit është bërë për shkak që nuk ka dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara sipas pikës 7 të konkursit, andaj nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke konsideruar se pretendimet tjera nuk ishin relevante për vendim ndryshe nga si është përmbajtja në dispozitiv të këtij vendimi ,dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.1303/2023, më datë 22/11/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.